



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



RAPORT PERIODIK VLERËSIMI

MBI PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË 6 MUJORIT TË PARË TË VITIT 2013 TË PËRCAKTUARA ME PROCESIN TARIFOR 2012-2014

ANALIZA: 6 mujore 2013

9 mujore

vjetore 2013

DFTRR/ZRRUK

Prishtinë, Gusht 2013

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

1	Hyrje	5
2	Sfidimi i biznes planeve rregullatore	6
3	Aplikimi i inflacionit	7
4	Metodologjia e vlerësimit të caqeve	8
5.	Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët	9
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	10
6.	Analiza e shpenzimeve operative	12
6. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	13
6.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza	14
7.	SHUMAT E Faturimit dhe arkëtimi në vlerë monetare	16
7.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	17
7.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza.....	18
7.3.	Shuma e arkëtitimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza	19
7.4.	Paraqitja grafike e arkëtitimit për ujë dhe ujëra të zeza	20
8.	Investimet kapitale	21
8.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	22
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive	25
8.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	26
8.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	29
8.5.	Investimet në përtëritjen e infrastrukturës.....	30
9.	Rekomandimet	32

Akronimet dhe shkurtesat

BPRR	Biznes Plane Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
FE	Kompania Rajonale e Ujit “Bifurkacioni” sh.a –Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujit “Radoniqi” sh.a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujit “Hidromorava” sh.a –Gjilan
MIT	Kompania Rajonale e Ujit “Mitrovica” sh.a – Mitrovicë
PE	Kompania Rajonale e Ujit “Hidrodrini” sh.a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujit “Prishtina” sh.a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujit “Hidroregjioni-Jugor” sh.a – Prizren
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve

1 HYRJE

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet përmbushja e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovua nga procesi tarifor 2012-2014, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 në mënyrë që këto të krahasohen me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2012.

Qëllimi i këtij raporti është:

- (i) Të jepet informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për përdhën e shikuar kohore.
- (ii) Të krahasohen treguesit e punës së KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tariforë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendët e tilla.

Duke pasur parasysh që KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që i ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Edhe pse në raportin përmbyllës tarifar 2012-2014 është përshkruar në detaje mënyra se si ZRRUK ka sfiduar BPRR-t e kompanive gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, kemi konsideruar të arsyeshme që edhe në këtë raport të bëjmë një përshkrim të shkurtër se si ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më eficientë në shërbimet e tyre ndaj konsumatorëve.

Parimi bazë i procesit rregullatorë ka qenë qëndrueshmëria financiare për kompanitë që nënkupton shërbime më të mira për konsumatorët e shërbyer, të cilat shpresojmë se do të arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për tu paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të performancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ZRRUK mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2012-2014.

Prandaj, ZRRUK do të;

- kryej monitorimin e rregullt për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator (siç po bëjmë edhe me këtë raport) ,
- mos përmbushja e caqeve të përcaktuara për vitin 2013 do të ketë si pasojë veprimet legjitime të ZRRUK-ut për të rishikuar tarifat e vitit 2014, të raportojë gjetjet tek aksionari në cilësinë e pronarit të kompanive dhe te palët tjera të interesit.

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

Përderisa qëllimi i këtij raporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013 dhe për të qenë vlerësimi në të sa më real, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK, të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeksën e Çmimeve të Konsumit në Kosovë publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës të periudhës vlerësuese.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2011 (Qershor 2011 = 121.4), ngase BPRR për procesin tarifor 2012-2014 janë dorëzuara gjatë asaj kohe.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK ndryshojnë prej të dhënave financiare që gjenden në BPRR, tek secila KRU.

Të dhënat financiare të aprovuara, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ve duke i shumëzuar me IÇKK 1.04997. Ky indeks është fituar duke pjesëtuar mesataren e IÇKK për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013 (127.467) me IÇKK mesit të vitit 2011 (121.4).

Sikurse edhe u theksua më lartë qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014 për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.

4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014 për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013, do të jetë uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2012,
- të dhënat e aprovuara nga ZRRUK për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013,
- të dhënat e realizuara nga KRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013,
- përqindja krahasuese e vitit 2013 me atë të vitit 2012,
- përqindja e realizimit të caktuar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese e gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2012 është raporti i të dhënave të dala nga treguesit e arritur të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja e realizimit të caktuar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013 del si rezultat i raportit të dhënave të përcaktuar si cak për çdo kompani veç e veç dhe sektorit në përgjithësi me të dhënat e realizuara nga KRU-të dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i rregullatorit, dhe identifikohet si:

Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
R	E realizuar	Pozitiv
Jo e R	Jo e realizuar	Negativ
T P	Tejkaluar pozitivisht	Pozitiv
T N	Tejkaluar negativisht	Negativ
E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

5. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT




Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit të shprehura në metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (iv) dhe numrin e konsumatorëve.


Tabela Nr. 1. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të vitit 2013 krahasuar me të dhënat e vitit 2012 dhe ato të caqeve të përcaktuara për 6-mujorin parë të këtij viti dhe të për ta përcaktuar % e përbushjes së caqeve.

Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësia	Historike 6m 2012	Aprovuara 6m 2013	Realizuara nga KRU-të 6m 2013	% krahasuese 6m2013/6m2012	% e real. të caktut 6m 2013	Vlerësimi për 6 mujorin e parë të vitit 2013
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	22,165,832	24,058,334	21,015,113	94.81%	87.35%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	11,755,589	11,602,855	10,570,873	89.92%	91.11%	R
	Uji i faturuar	m ³	10,410,243	12,455,479	10,444,240	100.33%	83.85%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	101,636	105,418	109,833	108.07%	104.19%	R
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	9,097,488	10,183,744	9,418,806	103.53%	92.49%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	5,519,967	6,261,819	5,663,396	102.60%	90.44%	R
	Uji i faturuar	m ³	3,547,521	3,921,925	3,755,410	105.86%	95.75%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	34,960	34,140	37,067	106.03%	108.57%	R
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	13,410,473	14,341,647	13,405,910	99.97%	93.48%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	8,953,200	9,761,602	9,680,571	108.12%	99.17%	R
	Uji i faturuar	m ³	4,457,273	4,580,045	3,725,339	83.58%	81.34%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	32,585	33,059	33,554	102.97%	101.50%	R
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	8,789,867	9,320,000	8,477,879	96.45%	90.96%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	4,307,727	4,472,805	4,059,604	94.24%	90.76%	R
	Uji i faturuar	m ³	4,482,140	4,847,196	4,418,275	98.58%	91.15%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	22,443	23,966	26,240	116.92%	109.49%	R
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	10,102,759	10,254,494	7,497,951	74.22%	73.12%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	7,182,490	6,978,506	4,069,723	56.66%	58.32%	R
	Uji i faturuar	m ³	2,920,269	3,275,989	3,428,228	117.39%	104.65%	R
	Konsumatorët	Nr	27,789	29,406	28,883	103.94%	98.22%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	2,941,536	3,228,119	2,943,162	100.06%	91.17%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	1,737,447	1,498,134	1,535,118	88.35%	102.47%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	1,204,089	1,729,985	1,408,044	116.94%	81.39%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	17,264	18,878	18,102	104.85%	95.89%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	3,550,670	3,613,770	3,703,725	104.31%	102.49%	R
	Uji i humbur	m ³	2,123,689	1,902,305	2,041,536	96.13%	107.32%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	1,426,981	1,711,465	1,662,189	116.48%	97.12%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	20,568	19,806	22,026	107.09%	111.21%	R
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	70,058,625	75,000,107	66,462,546	94.87%	88.62%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	41,580,109	42,478,025	37,620,821	90.48%	88.57%	R
	Uji i faturuar	m ³	28,448,516	32,522,082	28,841,725	101.38%	88.68%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	257,245	264,673	275,705	107.18%	104.17%	R


5.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin më të lehtë vizual të të dhënave historike të 6 mujorit të parë të vitit 2012 me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK dhe të dhënave të realizuara nga KRU-të gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013.





Për herë të parë Rregullatori do të paraqet gjendjen e sektorit të ujit në Kosovë duke shfrytëzuar **Diagramin Merimangë**. Përpos tek të dhënave operative, ky diagram do të paraqitet edhe te kategoritë tjera të të dhënave në këtë raport.



Septagrami (Iakorja) me ngjyrë të kuqe (shtatë këndesh) paraqet sasinë e ujit të prodhuar nga të gjitha KRU-të në Kosovë shprehur në përqindje. Hapësira e kaltër tregon sa përqind e ujit të prodhuar faturohet. Ndërkaq, hapësira me ngjyrë të gjelbër paraqet në përqindje se sa prej ujit të prodhuar arkëtohet.

Prej këtu mund të kuptojmë se diferenca në mes të septagramit (lakores ngjyrë kuqe) dhe hapësirës me ngjyrë të kaltër paraqet ujin e humbur për çdo kompani veç e veç dhe për sektor, kurse diferenca në mes të hapësirës së kaltër dhe hapësirës së gjelbër paraqet llogaritë e arkëtueshme–borxhet e konsumatorëve ndaj kompanive.

Për të qenë KRU-të në gjendje të mirë financiare dhe me nivele të kënaqshme të shërbimit për konsumatorët e tyre, kompanitë duhet të ngrisin performancën e tyre në krahasim me atë që është.

6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifar 2012-2014, ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRUK (www.wwro-ks.org).


6.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektor, duke paraqitur shpenzimet operative historike të gjashtë mujorit të parë të vitit 2012, ato të aprovuara nga ZRRUK si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013, shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe vlerësimi përfundimtarë për këtë periudhë kohore.



Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €


Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	Historike 6m 2012	Aprovuar nga ZRRUK 6m 2013	Realizuara nga KRU 6m 2013	% krahasuese 6m2013 / 6m2012	% e real. të caktut 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar për 6 mujorin e parë 2013
Prishtina (PR)	Ujë	€	3,667,736	2,820,626	3,821,871	104.20%	135.50%	TN
	Ujëra të Zeza	€	118,690	103,893	127,537	107.45%	122.76%	TN
	Totali	€	3,786,426	2,924,519	3,949,408	104.30%	135.04%	TN
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,234,548	1,220,057	1,302,929	105.54%	106.79%	TN
	Ujëra të Zeza	€	63,897	68,884	120,191	188.10%	174.48%	TN
	Totali	€	1,298,445	1,288,942	1,423,120	109.60%	110.41%	TN
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	781,066	808,593	820,261	105.02%	101.44%	TN
	Ujëra të Zeza	€	34,421	43,996	36,915	107.25%	83.90%	R
	Totali	€	815,487	852,589	857,176	105.11%	100.54%	TN
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	950,123	860,182	917,123	96.53%	106.62%	TN
	Ujëra të Zeza	€	46,837	85,640	92,274	197.01%	107.75%	TN
	Totali	€	996,960	945,822	1,009,397	101.25%	106.72%	TN
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	954,420	811,061	1,138,741	119.31%	140.40%	TN
	Ujëra të Zeza	€	44,392	42,157	52,359	117.95%	124.20%	TN
	Totali	€	998,812	853,218	1,191,100	119.25%	139.60%	TN
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	343,943	378,058	352,152	102.39%	93.15%	R
	Ujëra të Zeza	€	32,156	27,995	55,379	172.22%	197.82%	TN
	Totali	€	376,099	406,053	407,531	108.36%	100.36%	TN
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	522,690	469,383	550,602	105.34%	117.30%	TN
	Ujëra të Zeza	€	52,527	39,758	55,752	106.14%	140.23%	TN
	Totali	€	575,217	509,142	606,354	105.41%	119.09%	TN
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	8,454,526	7,367,960	8,903,679	105.31%	120.84%	TN
	Ujëra të Zeza	€	392,920	412,325	540,407	137.54%	131.06%	TN
Totali i përgjithshëm sektorial		€	8,847,446	7,780,285	9,444,086	106.74%	121.38%	TN

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013, 94.28% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 5.72% janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 është 9,444,086 €, të cilat si të tilla janë tejkaluar nga shuma e aprovuar nga ZRRUK për këtë periudhë në lartësi prej 21.38%.



6.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza





Prej grafikonit të mësipërm shihet se nga shuma e shpenzimeve të aprovuar për periudhën e shikuar për 6 mujorin e parë të vitit 2013, përveç KRU “Hidrodrini” sh. a. Pejë dhe KRU “Bifurkacioni” sh. a. Ferizaj që kanë arrit t’i mbajnë shpenzimet operative nën kontroll.

Është e ditur se kostoja e pagave për të punësuarit e të gjitha KRU-të paraqesin zërat më të larta të tyre dhe për ti pasqyruar të njëjtat në raport me kostot tjera po i paraqesim në Tabelën e më poshtme, prej nga mund të kuptojmë lehtë se cila kompani menaxhon më mirë me zërin e pagave. Pos tjerash në këtë tabelë do të paraqitet edhe paga mesatare për secilën kompani.

Tabela Nr. 3 Shpenzimet e pagave në raport me shpenzimet totale dhe paga mesatare për 6 mujorin e parë të vitit 2013

Emri i Kompanisë	Totali i shpenzimeve operative	Shpenzimet e pagave	Numri i punëtorëve	Përqindja e pagave në raport me shpenzimet	Paga mesatare mujore
	€	€	Nr	%	€/muaj
PRISHTINA	3,949,408	2,095,819	539	53.07%	648.06
HIDROREGJIONI-JUGOR	1,423,120	806,173	284	56.65%	473.11
HIDRODRINI	857,176	527,611	186	61.55%	472.77
MITROVICA	1,009,397	591,262	226	58.58%	436.03
RADONIQI	1,191,100	818,822	237	68.75%	575.82
BIFURKACIONI	407,531	280,737	112	68.89%	417.76
HIDROMORAVA	606,354	315,497	149	52.03%	352.90
SEKTORI	9,444,086	5,435,921	1733	57.56%	522.79

7. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga kompanitë dhe sektori gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 me ato të aprovuara nga ZRRUK për të njëjtën periudhë kohore, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2012-2014.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar të gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2012.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ZRRUK në Mars të vitit 2011, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetike i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim i atribuohet si e vetme shërbimeve të ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ZRRUK ka qenë i detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi të cilin ne e kemi konsideruar si më të arsyeshmin, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ZRRUK dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektori të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit, që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ZRRUK-ut të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.


7.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të gjashtë mujorit të parë të vitit 2012, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013.




Tabela Nr. 4 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Njësia	Historike 6m 2012	Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013	Realizuara nga KRU 6m 2013	% krahasues e 6m2013/6m2012	% e real. të caktut 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,674,126	7,370,983	5,977,410	105.35%	81.09%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	522,163	710,558	567,879	108.76%	79.92%	Jo e R
	Totali	€	6,196,289	8,081,542	6,545,289	105.63%	80.99%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,562,148	2,119,213	1,841,941	117.91%	86.92%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	180,900	232,413	192,333	106.32%	82.75%	Jo e R
	Totali	€	1,743,048	2,351,626	2,034,274	116.71%	86.51%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,324,333	1,662,065	1,288,836	97.32%	77.54%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	143,273	209,271	108,119	75.46%	51.66%	Jo e R
	Totali	€	1,467,606	1,871,336	1,396,955	95.19%	74.65%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë-Jugu	€	1,331,973	1,354,870	980,835	73.64%	72.39%	Jo e R
	Ujë-Veriu		n/a	382,500	398,961	!	104.30%	TP
	Ujëra të Zeza	€	179,503	304,807	200,187	111.52%	65.68%	Jo e R
	Totali	€	1,511,476	1,659,677	1,579,983	104.53%	95.20%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,406,154	1,624,153	1,527,086	108.60%	94.02%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	48,396	219,335	191,787	396.29%	87.44%	Jo e R
	Totali	€	1,454,550	1,843,488	1,718,873	118.17%	93.24%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	526,764	791,415	659,482	125.19%	83.33%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	104,960	229,252	117,709	112.15%	51.34%	Jo e R
	Totali	€	631,724	1,020,666	777,191	123.03%	76.15%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	645,263	841,468	719,838	111.56%	85.55%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	121,497	181,292	141,172	116.19%	77.87%	Jo e R
	Totali	€	766,760	1,022,760	861,010	112.29%	84.18%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	12,470,761	15,764,166	13,394,389	107.41%	84.97%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,300,692	2,086,928	1,519,186	116.80%	72.80%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial	€	13,771,453	17,851,093	14,913,575	108.29%	83.54%	Jo e R	

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë, 89.81 % të shumës së faturimit realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 10.19% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 është realizuar faturimi në vlerë prej 14,913,575€, e që paraqet 83.54% të shumës së aprovuar nga procesi rregullatorë për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.



7.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikonin merimangë vërehet se asnjëra KRU nuk ka arritur të realizoj faturimin në Euro ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013, përveç KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për shumën e faturimit në pjesën veriore të qytetit të cilën shumë e ka tejkaluar nga shuma e planifikuar për periudhën e shikuar.


7.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të gjashtë mujorit të parë të vitit 2012, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 të cilat si të tilla krahasohen dhe vlerësohen sipas pasqyrës së mëposhtme.




Tabela Nr. 5 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Faturimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 6m 2012	Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013	Realizuara nga KRU 6m 2013	% krahasuese 6m2013/6m2012	% e real. të caktut 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	3,998,860	5,595,790	4,128,053	103.23%	73.77%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	363,817	554,934	360,973	99.22%	65.05%	Jo e R
	Totali	€	4,362,677	6,150,724	4,489,026	102.90%	72.98%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,124,739	1,589,436	1,289,979	114.69%	81.16%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	130,247	175,467	134,712	103.43%	76.77%	Jo e R
	Totali	€	1,254,986	1,764,903	1,424,691	113.52%	80.72%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	683,407	1,212,358	697,261	102.03%	57.51%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	73,934	157,997	58,492	79.11%	37.02%	Jo e R
	Totali	€	757,341	1,370,355	755,753	99.79%	55.15%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	509,370	859,995	449,008	88.15%	52.21%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	53,850	209,422	91,967	170.78%	43.91%	Jo e R
	Subvencionet	€	469,237	192,500	183,306	39.06%	95.22%	Jo e R
	Totali i konsu.	€	563,220	1,069,417	540,975	96.05%	50.59%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,061,294	1,266,842	1,064,560	100.31%	84.03%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	36,527	172,264	133,639	365.86%	77.58%	Jo e R
	Totali	€	1,097,821	1,439,106	1,198,199	109.14%	83.26%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	292,706	553,735	358,967	122.64%	64.83%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	58,302	162,761	64,093	109.93%	39.38%	Jo e R
	Totali	€	351,008	716,496	423,060	120.53%	59.05%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	420,142	673,954	478,326	113.85%	70.97%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	79,136	146,698	93,698	118.40%	63.87%	Jo e R
	Totali	€	499,278	820,652	572,024	114.57%	69.70%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	8,090,518	11,752,109	8,466,154	104.64%	72.04%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	795,813	1,579,544	937,574	117.81%	59.36%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	8,886,331	13,331,653	9,403,728	105.82%	70.54%	Jo e R

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ZRRUK të gjashtë mujorit të parë të vitit 2013, 90.03% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 9.97% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë këtij gjashtë mujori është realizuar arkëtimi në vlerë prej 9,403,728€, e që paraqet 70.54% të shumës së aprovuar gjatë procesit tarifor për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.



7.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni merimangë vërehet se asnjëra nga KRU-të nuk ka arritur të realizoj arkëtimin ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.

Të hyrat nga subvencionet për mbulim të shpenzimeve operative në KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për periudhën e shikuar janë 183,306 €, dhe kjo shtesë është paraqitur me vijë të gjelbër në grafikun.

8. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2012-2014, ZRRUK ka paraparë që të ndërmerren investime kapitale të konsiderueshme prej të gjitha kompanive të ujësjellësit, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në webfaqen zyrtare të ZRRUK.

8.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit. Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ZRRUK me ato të realizuara nga KRU-të gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2013, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtarë.

Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujë te financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 6m 2013	Realizuara 6m 2013	% e real. të cakt 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	3,011,363	554,974	18.43%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	678,282	178,374	26.30%	Jo e R
Distribuem	2,099,035	362,307	17.26%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	234,045	14,292	6.11%	Jo e R
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	52,499	89,187	169.88%	R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	57,724	!	E pa K
Distribuem	52,499	23,003	43.82%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	8,460	!	E pa K
3. HIDRODRINI	323,188	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E p K
Distribuem	321,692	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	1,496	0	0.00%	Jo e R
4. MITROVICA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuem	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	199,197	209,337	105.09%	TP
Resurse dhe trajtimi i ujit	5,250	16,211	308.78%	TP
Distribuem	193,947	121,390	62.59%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	71,737	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	58,086	16,260	27.99%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	18,375	4,259	23.18%	Jo e R
Distribuem	39,712	5,072	12.77%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	6,929	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	94,892	13,180	13.89%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	15,750	2,250	14.29%	Jo e R
Distribuem	79,142	1,488	1.88%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	9,441	!	E pa K
TOTALI	3,739,224	882,938	23.61%	Jo e R




Tabela Nr. 7. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara më lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 6m 2013	Realizuara 6m 2013	% e real. të cakt. 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	246,478	8,810	3.57%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	186,741	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	52,499	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	7,239	8,810	121.71%	R
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	61,908	789	1.27%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	61,908	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	0	789	!	R
3. HIDRODRINI	78,827	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	78,748	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	79	0	0.00%	Jo e R
4. MITROVICA	71,451	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	71,451	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	76,701	3,055	3.98%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	76,701	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	0	3,055	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	104,149	796	0.76%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	104,149	796	0.76%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	59,388	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	59,388	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivite të biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	698,901	13,450	1.92%	Jo e R

Tabela Nr. 8. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanke të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në €

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 6m 2012	Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013	Realizuar nga KRU 6m 2013	% krahasuese 6m2013/ 6m 2012	% e real. të caktut 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar 2013
Prishtina	Ujë	€	184,434	3,011,363	554,974	300.91%	18.43%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,259	246,478	8,810	699.75%	3.57%	Jo e R
	Totali	€	185,693	3,257,841	563,783	303.61%	17.31%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	50,403	52,499	89,187	176.95%	169.88%	R
	Ujëra të zeza	€	5,073	61,908	789	15.55%	1.27%	Jo e R
	Totali	€	55,476	114,407	89,976	162.19%	78.65%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	3,916	323,188	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	78,827	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	3,916	402,015	0	0.00%	0.00%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	0	71,451	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	0	71,451	0	!	0.00%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	35,937	199,197	209,377	582.51%	105.09%	R
	Ujëra të zeza	€	1,510	76,701	3,055	202.32%	3.98%	Jo e R
	Totali	€	37,447	275,897	212,392	567.18%	76.98%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	28,931	58,086	16,260	56.20%	27.99%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	2,768	104,149	796	28.75%	0.76%	Jo e R
	Totali	€	31,699	162,235	17,056	53.81%	10.51%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	41,116	94,892	13,180	32.05%	13.89%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,255	59,388	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	42,371	154,280	13,180	31.11%	8.54%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	344,737	3,739,224	882,938	256.12%	23.61%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	11,865	698,901	13,450	113.35%	1.92%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	356,602	4,438,125	896,387	251.37%	20.20%	Jo e R

8.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive



8.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2013. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë.

Tabela Nr. 9. Shumat e investimeve kapitale për ujë te financuar nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 6m 2013	Realizuara 6m 2013	% e real. të cakt 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	2,941,685	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	233,094	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	2,708,591	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	201,854	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	165,105	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	36,749	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
3. HIDRODRINI	792,729	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	367,490	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	425,239	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
4. MITROVICA	4,903,372	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	4,724,876	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	178,495	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	78,748	68,816	87.39%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	78,748	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	0	68,816	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	317,480	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	317,480	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	9,235,868	68,816	0.75%	Jo e R




Tabela Nr. 10. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuara nga donatorët sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 6m 2013	Realizuara 6m 2013	% e real. të caktut 6m 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	271,418	0	0.00%	E pa K
Grumbullimi i u.z	245,169	0	0.00%	E pa K
Trajtim i u.z	26,249	0	0.00%	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	468,288	15,004	3.20%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	468,288	0	0.00%	E pa K
Trajtim i u.z	0	970	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	14,034	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
3. HIDRODRINI	1,338,715	0	0.00%	E pa K
Grumbullimi i u.z	1,049,973	0	0.00%	E pa K
Trajtim i u.z	288,742	0	0.00%	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
4. MITROVICA	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	2,078,421	15,004	0.72%	Jo e R

Tabela Nr. 11. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 6m 2012	Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013	Realizuar nga KRU 6m 2013	% krahasues 6m2013/ 6m 2012	% e real. të caktut 6m 2012	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	163,617	2,941,685	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	271,418	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	163,617	3,213,103	0	0.00%	0.00%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	53,051	201,854	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	3,577	468,288	15,004	419.46%	3.20%	Jo e R
	Totali	€	56,628	670,142	15,004	26.50%	2.24%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	0	792,729	0	!	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	1,338,715	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	0	2,131,444	0	!	0.00%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0	4,903,372	0	!	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	4,903,372	0	!	0.00%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	3,031	78,748	68,816	2,270.40%	87.39%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	3,031	78,748	68,816	2,270.40%	87.39%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	0	317,480	0	!	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	317,480	0	!	0.00%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	0	0	!	!	E pa K
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	219,699	9,235,868	68,816	31.32%	0.75%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	3,577	2,078,421	15,004	419.46%	0.72%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	223,276	11,314,289	83,820	37.54%	0.74%	Jo e R

8.4. Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët




8.5. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës

Është e njohur nga praktika e gjertanishme se të gjitha asetet kanë një jetëgjatësi të caktuar, prandaj për to alokohet pjesa përkatëse e mjeteve financiare (në rastin tonë asetet jo-infrastrukturore) në mënyrë që në fund të jetëgjatësisë së tyre tu zgajtet vlera e përdorimit të tyre ose të blihen asete të reja dhe të zëvendësohen me ato të vjetrat. Karakteristikë e kontabilitetit rregullator është se asetet të cilat gjenden nën nivelin e tokës (asetet infrastrukturore) nuk amortizohen, por u njihet shpenzimi për përtëritjen e infrastrukturës në shumën e aprovuar me procesin rregullator. ZRRUK ka konstatuar se kjo kategori e investime ka ndikim direkt në nivelin e shërbimeve.

Shuma e duhur e mjeteve financiare të nevojshme për përtëritje efektive infrastrukturore është vështirë të përcaktohet, por pas një periudhe të arsyeshme kohore dhe me të dhëna të mjaftueshme për shpenzime dhe për performancë është e mundur që të ndërlihet shkalla e shpenzimeve me përmirësimin apo përkeqësimin e shërbyeshmërisë së infrastrukturës.

Në mungesë të të dhënave të besueshme për performancën e menaxhimit të aseteve në shqyrtimin tarifor 2012-2014, shumën e mjeteve fillestare të planifikuara për investime në përtëritjen e infrastrukturës është përcaktuar si një shpenzim vjetor prej të paktën 10% të vlerës së BRA për shërbimet e furnizimit me ujë dhe 10% të vlerës së BRA të sistemit për shërbimet e ujërave të zeza. Për procesin rregullator të tarifave 2012-2014 pas akordimit të arritur për të siguruar një nivel më të mirë të shërbimeve dhe ngritje minimale të tarifave reale është vendosur që tarifat e shërbimeve të ujit të ngriten për BRRR të ujit me 4% vit pas viti dhe ato të shërbimeve të ujërave të zeza me 10%. Ky proces është i ilustruar në figurën mëposhtme.



Sipas këtij procesi, për të gjitha KRU-të janë bërë rregullimet e nevojshme për të pasqyruar shumat e përtëritjes së infrastrukturës, siç edhe do të paraqiten në tabelat në vijim për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.

Tabela Nr. 12. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujë

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 6m 2013		Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013		Realizuara nga KRU 6m 2013		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	1,142,370	1,886,801	1,679,046	1,886,801	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	0	0	0	0	860	140,760	E pa K	E pa K
HIDRODRINI	0	157,496	111,697	157,496	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	0	0	0	0	Jo e R	Jo e R
RADONIQI	5,250	78,748	199,197	78,748	953	0	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	7,875	212,483	46,011	212,483	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	0	79,142	0	0	0	Jo e R	Jo e R
TOTALI	1,155,495	2,335,527	2,115,094	2,335,527	1,813	140,760	Jo e R	Jo e R

Tabela Nr. 13. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujëra të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 6m 2013		Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013		Realizuara nga KRU 6m 2013		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	11,550	245,169	186,741	245,169	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	52,499	0	61,908	0	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDRODRINI	78,748	1,338,71	78,748	1,338,71	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	71,451	0	0	0	Jo e R	Jo e R
RADONIQI	5,250	0	76,701	0	0	0	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	787	0	103,099	0	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	0	59,388	0	0	0	Jo e R	Jo e R
TOTALI	148,834	1,583,88	638,035	1,583,88	0	0	Jo e R	Jo e R

Tabela Nr.14. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 6m 2013		Aprovuara nga ZRRUK 6m 2013		Realizuara nga KRU 6m 2013		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	1,153,92	2,131,96	1,865,78	2,131,96	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	52,499	0	61,908	0	860	140,760	Jo e R	Jo e R
HIDRODRINI	78,748	1,496,21	190,445	1,496,21	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	71,451	0	0	0	Jo e R	Jo e R
RADONIQI	10,500	78,748	275,897	78,748	953	0	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	8,662	212,483	149,110	212,483	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	0	138,531	0	0	0	Jo e R	Jo e R
TOTALI	1,304,328	3,919,411	2,753,129	3,919,411	1,813	140,760	Jo e R	Jo e R

9. Rekomandimet

Nga ajo që u theksua ma lartë, duhet theksuar se qëllimi i këtij raporti është të sensibilizoj të gjithë akterët në sektorin e ujit për ecurinë e përmbushjes /mos përmbushjes së caqeve të përcaktuara në procesin tarifor për periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2013. Siç dihet, objektivat e përcaktuara nga ZRRUK me KRU-të, paraqesin “Marrëveshje Kontraktuale” për të cilat KRU-të janë të obliguara të punojnë në përmbushjen e tyre pasi që të njëjtat kanë ngarkuar tarifat e aplikuara.

- **Te dhënat operative**

Sa i përket të dhënave operative në baza sektoriale nga katër indikatorët që janë marrë në shqyrtim dy prej tyre janë vlerësuar pozitivisht dhe dy negativisht. Sasia e ujit të prodhuar është vlerësuar negativisht ngase sasia e prodhuar është më e vogël se sasia e aprovuar nga ZRRUK. Edhe sasia e ujit të faturuar është nën vlerat e aprovuara dhe është vlerësuar negativisht derisa sasia e ujit të humbur është më e vogël nga sasia e pranuar nga rregullatori dhe për këtë vlerësimi është pozitiv sikur edhe për numrin e konsumatorëve ku kemi tejkalim në krahasim me parashikimet me biznes planet rregullatore.

- **Shpenzimet operative**

Përpos KRU “Hidrodrini” dhe “Bifurkacioni” që kanë arritur të kenë në kontroll shpenzimet operative për këtë periudhë kohore, të gjitha KRU-të tjera kanë shpenzuar më shumë sesa u është aprovuar nga Rregullatori. Për këtë rekomandohen KRU-të që për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2013 të jenë më efektiv duke mbajtur në kontroll shpenzimet e tyre operative.

- **Faturimi në vlerë monetare**

As një nga kompanitë nuk ka arrit me realizuar shumën e faturimit të aprovuar për periudhën e shikuar kohore edhe pse për nga angazhimi i tyre dallohen nga të tjerat KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë dhe KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë me furnizimin e ujit me shumicë të trajtuar të veriut të qytetit. Rekomandohen të gjitha KRU-të që të angazhohen më shumë për rritjen faturimin në vlerë monetare për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2013.

- **Arkëtimi në vlerë monetare**

Të gjitha KRU-të që operojnë në Kosovë, janë larg realizimit të shkallës së arkëtimit krahasuar me atë që është aprovuar nga Rregullatori për këtë periudhë kohore. Mund të themi se më të angazhuarit në këtë drejtim janë KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë dhe KRU “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren të cilët kanë arritur të përmbushin cakun mbi 80%. Të gjitha KRU-të duhet të angazhohen më shumë në përmirësimin e shkallës së arkëtimit.

- **Investimet Kapitale**

Çështja e Investimeve Kapitale vazhdon të mbetet njëra ndër pikat më të dobëta për t’u realizuar nga KRU-të në Kosovë. Vetëm KRU “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren dhe KRU “Radoniqi” sh.a –Gjakovë kanë arritur të realizojnë investime prej burimeve vetanake të cilat kapin vlerën mbi 70% . Ndërkaq, të gjitha KRU-të tjera janë në një pozitë shumë të dobët të realizimit të investimeve prej burimeve vetanake. Rekomandohen KRU-të që të menaxhojnë në mënyrë efikase dhe të realizojnë investimet të cilat Rregullatori i ka aprovuar gjatë procesit rregullator.